



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 42 regjistër (JR)  
Datë 28.10.2024

Nr. 24 i vendimit  
Datë 05.03.2026

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

– shpalli në seancë gjyqësore publike, ditën e enjte, datë 05.03.2026, në orën 16:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 42/2024 (JR), që i përket:

**ANKUES:** Komisioneri Publik Florjan Ballhysa.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 779, datë 28.06.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Aurel Zarka.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, i përfaqësuar me autorizim nga prokurori pranë Prokurorisë së

Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, z. Adnan Xholi<sup>1</sup>, i cili kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 779, datë 28.06.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Aurel Zarka, dëgjoi përfaqësuesin ligjor të subjektit të rivlerësimit, z. Julian Mërtiri, që përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë në prani të vëzhguesit ndërkombëtar Francesco Ciardi,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Aurel Zarka (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka administruar raportet e hartuara për subjektin e rivlerësimit nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim “AKSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).

2.1. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pas procedurës së kontrollit të plotë për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Aurel Zarka, ka dërguar në Komision një raport në të cilin ka konstatuar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë*; (iii) *ka mosdeklarim të pasurisë ndër vite*; (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

2.2. AKSIK -ja, në përputhje me kërkesat e nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur pranë Komisionit raportin për subjektin e rivlerësimit Aurel Zarka, të deklasifikuar plotësisht, me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

2.3. KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe, në përfundim, ka dërguar një raport të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Vendimi i Komisionit për subjektin e rivlerësimit Aurel Zarka është marrë bazuar në të tri kriteret rivlerësimit: vlerësimin të pasurisë, kontrollin të figurës dhe vlerësimin të aftësive profesionale, për të cilat është konkluduar se: (i) ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; (ii) ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; (iii) ka arritur nivel

---

<sup>1</sup> Sipas autorizimit “Për përfaqësimin e çështjes në seancë publike” nr. {\*\*\*} prot., datë 01.10.2025.

kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

4. Në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar, Komisioni, me vendimin nr. 779, datë 28.06.2024, ka vendosur: *“Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Aurel Zarka, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë”*.

### **III. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit**

5. Bazuar në nenin B, pika 3, shkronja “c” e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 2<sup>2</sup> e ligjit nr. 84/2016, një Komision i përbërë nga tre përfaqësues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, (në vijim ONM), më datë 8.10.2024, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë: *“Rekomandim për paraqitje ankimi” ndaj vendimit nr. 779, datë 28.6.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Aurel Zarka”*.
6. Komisioni prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të ONM-së, ndër të tjera, ka referuar se: [...] *Trupi gjykues i Komisionit, në datën 28.06.2024, bazuar në nenin 59, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, ka shpallur publikisht vendimin për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Aurel Zarka. Pas shpalljes së vendimit të Komisionit, në datën 30.7.2024, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në një njoftim për shtyp, ka njoftuar se: “Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, mbi bazën e verifikimeve të kryera kryesisht, ka regjistruar procedimin penal nr.{\*\*\*}, datë 07.02.2024, për veprat penale “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, “Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete” dhe “Trafikimi i narkotikëve”, të parashikuara nga nenet 245/1, 319, 319/ç, 295/a, paragrafi 3 dhe 283/a të Kodit Penal. [...] Caktimin ndaj personit nën hetim A. Z. (në cilësinë e prokurorit), të masës së sigurimit “arrest me burg”, e parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, i dyshuar për veprat penale: (i) “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, e kryer tre herë, e kryer në bashkëpunim dy herë, të parashikuar nga nenet 245/1, paragrafi (2) dhe 25 të Kodit Penal (para ndryshimeve me ligjin nr. 43/2021); (ii) “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 319 dhe 25 i Kodit Penal; (iii) “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal.*

*Në zbatim të nenit Ç, paragrafi 4, fjalia e 2-të e Aneksit të Kushtetutës, ONM i ka kërkuar SPAK-ut t'i vërë në dispozicion akte nga dosja e procedimit penal, duke përfshirë kërkesën e SPAK dhe vendimin e Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (Gjykata e Posaçme). SPAK i ka kërkuar Gjykatës të Posaçme caktimin e masës së sigurisë të paraburgimit kundër Aurel Zarkës, pasi subjekti i rivlerësimit dyshohet për kryerjen e veprave penale: (i) “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë*

---

<sup>2</sup> Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë t'i paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik, për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

*funksiione publike”, e kryer tre herë, e kryer në bashkëpunim dy herë, të parashikuar nga nenet 245/1, paragrafi (2) dhe 25 të Kodit Penal (para ndryshimeve me ligjin nr.43/2021); (ii) “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 319 dhe 25 i Kodit Penal; (iii) “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal. Me vendimin e Gjykatës së Posaçme nr. {\*\*\*}, datë 31.07.2024, është vendosur masa e sigurisë “Arrest me burg”, për subjektin e rivlerësimit [...].*

7. Vëzhguesit Ndërkombëtarë, në konkluzion të këtij rekomandimi, në mënyrë të përmbledhur, referojnë se: [...] ONM u rekomandon Komisionerëve Publikë të ankimojnë vendimin për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit. Rekomandimi i ONM-së është i bazuar në njoftimin për shtyp datë 30.07.2024, të SPAK-ut dhe vendimin e Gjykatës së Posaçme nr. {\*\*\*} akti, datë 31.07.2024. Ky ankim duhet t'i japë mundësi Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të realizojë një hetim të plotë të subjektit të rivlerësimit, vlerësimin e pasurisë së tij, si dhe vlerësimin e figurës dhe aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, gjë që do të siguronte që ai të gëzonte vërtet besimin e publikut, rikthimi i të cilit është synimi kryesor i procesit të vetting-ut dhe institucioneve që e zbatojnë atë [...].

#### **IV. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik**

8. Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, të datës 08.10.2024, ka ushtruar ankim ndaj vendimit nr. 779, datë 28.06.2024, të Komisionit, pasi, referuar rrethanave të reja të verifikuara nga procedimi penal nr. {\*\*\*}/2024, i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ka vlerësuar se Kolegji duhet të riçelë hetimin gjyqësor, për të tri kriteret e rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e pranisë së shkeljeve ligjore, sipas kriterëve të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Aurel Zarka.
9. Ankimi i Komisionerit Publik është bazuar në shkaqet e mëposhtme:

**9.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë,** ndryshe nga arsyetimi dhe përfundimet e Komisionit, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit pas kalimit të barrës së provës, në kuptim dhe zbatim të nenit D, paragrafët 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës. Komisioneri Publik vlerëson se të gjitha gjetjet lidhur me kriterin e pasurisë, së bashku me rrethanën e re të procedimit penal nr. {\*\*\*}, datë 07.02.2024, të SPAK-ut, duhen marrë në konsideratë nga Kolegji për të hetuar në drejtim të veprimeve të kryera nga subjekti, me qëllim për të justifikuar mbulim me burime të ligjshme të pasurive të deklaruara.

Konkretisht, Komisioneri Publik konstaton se: (i) në gjendjen që janë aktet nuk provohet shuma e të ardhurave të pretenduara si të përfituara nga i ndjeri, babai i subjektit të rivlerësimit në shtetin grek, që deklarohet si burim krijimi për huan në shumën 40.000 USD dhe që, në vijim, deklarohet si burim kryesor krijimi për pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën vetting (apartament banimi me sipërfaqe 110,4 m<sup>2</sup> dhe dy garazhe me sipërfaqe 20 m<sup>2</sup> secili, ndodhur në Selitë, Tiranë dhe apartament banimi me sipërfaqe 78 m<sup>2</sup>, ndodhur, në Vlorë); (ii) për pasurinë Fond Investimi në Raiffeisen Bank, me vlerë 9.118.267 lekë, konstaton se një nga burimet e krijimit të këtyre likuiditeteve janë të ardhurat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit nga shitja e apartamentit të banimit me sipërfaqe 59 m<sup>2</sup>, të ndodhur në bulevardin “{\*\*\*}”, Tiranë, në datën 31.10.2008, në vlerën 4.318.800 lekë. Komisioneri Publik vëren se ndërsa subjekti i rivlerësimit e ka shitur këtë apartament gati një vit e gjysmë më vonë, më

shumë se dyfishi i çmimit të blerjes, duket se subjekti duhet të jetë në kushtet e një veprimi juridik fiktiv/të simuluar dhe të ardhurat e përfituara nga këto transaksione afektojnë burimin e krijimit të pasurisë Fond Investimi në Raiffeisen Bank, me vlerë 9.118.267 lekë.

**9.2. Për kontrollin e figurës,** Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, referuar dokumentit bashkëlidhur këtij rekomandimi “Njoftim për shtyp i datës 30.07.2024”, i përcjellë nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, lidhur me procedimin penal me nr. {\*\*\*}, datë 07.02.2024, në kuadër të të cilit u dha vendimi i aksesuar nr. {\*\*\*} akti, datë 31.07.2024 (për caktimin e masave të sigurimit personal) nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, vlerëson se, me qëllim përmbushjen me objektivitet të kontrollit të figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës e të listuara në kreun V të ligjit nr. 84/2016, Kolegji duhet të çelë hetimin gjyqësor dhe t’i kërkojë AKSIK-së të përditësojë Raportin për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, në përputhje me detyrimet që ky institucion ka, në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016.

**9.3. Për vlerësimin e aftësive profesionale,** Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, të datës 8.10.2024, referuar dokumentit bashkëlidhur këtij rekomandimi “Njoftimi për shtyp i datës 30.7.2024”, për procedimin penal me nr. {\*\*\*}, datë 07.02.2024, përcjellë nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, në kuadër të të cilit u dha vendimi i aksesuar nr. {\*\*\*} akti, datë 31.07.2024 (për caktimin e masave të sigurimit personal), nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, vlerëson se rezultojnë shkaqe të bazuara për të kërkuar rivlerësim të kriterit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit. Prokuroria e Posaçme, në njoftimin për shtyp të datës 30.07.2024, duke konkretizuar episodet në të cilat ka dyshime të arsyeshme për konsumim të veprave penale, përshkruan edhe dy procedime penale si në vijim:

- (i) mosfillimin e procedimit penal për referimin penal me nr. {\*\*\*}, datë 26.03.2020, të dërguar nga Komisariati i Policisë Himarë, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë;
- (ii) çështjen penale në ngarkim të shtetasve A. V. etj., të akuzuar për veprën penale “Kultivimi i narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 248/2 i Kodit Penal, të gjykuar në Gjykatën e Shkallës së Parë Vlorë.

Komisioneri Publik vlerëson se referuar rrethanave të reja, përshkruar më lart, për sa kohë që procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit nuk ka përfunduar, me qëllim përmbushjen me objektivitet të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin E, të Aneksit të Kushtetutës, të listuara në kreun VI të ligjit nr. 84/2016, Kolegji duhet të çelë hetimin gjyqësor dhe të kërkojë administrimin e fashikujve të dy procedimeve penale të sipërcituara.

10. Në përfundim, Komisioneri Publik ka kërkuar nga Kolegji që të marrë në shqyrtim shkaqet e këtij ankimi, të riçelë hetimin gjyqësor për të tri kriteret e rivlerësimit, dhe, në përfundim të gjykimit, bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, Dh, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës dhe pikave 2, 3 dhe 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, dhe në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë në mënyrë alternative: - *Ndryshimin e vendimit nr. 779, datë 28.06.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; ose - Lënien në fuqi të këtij vendimi.*

## V. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

### A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

#### a) Juridiksioni i Kolegjit

11. Lidhur me juridiksionin e Kolegjit, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

#### b) Legjitimitimi i ankuesit

12. Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, për të drejtën e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Komisioneri Publik legjitimohet dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar brenda afatit ligjor 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 84/2016.

#### c) Shqyrtimit i ankimit në Kolegj

13. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për të garantuar zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, çështja objekt gjykimi u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, në prani të palëve, të cilat u zhvilluan në datat 06.10.2025, 13.11.2025, 29.01.2026, 10.02.2026 dhe 05.03.2025.
14. Në seancën gjyqësore publike të datës 06.10.2025, trupi gjykues, për shkak të mbarimit të mandatit kushtetues të institucionit të Komisionerëve Publikë, në zbatim të nenit 179/b, pika 8 të Kushtetutës dhe nenit 199, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile, vendosi kalimin procedural nga Komisioneri Publik te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.
15. Kolegji i Posaçëm i Apelit, në seancën gjyqësore publike të datës 06.10.2025, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të riçelë hetimin gjyqësor të çështjes (JR) nr. 42/2024, për të kërkuar zyrtarisht nga:
  - a) Agjencia Kombëtare e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, raportin e përditësuar mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Aurel Zarka;
  - b) Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë ,si dhe nga Gjykata e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar:
    - (i) aktet e fashikullit të mosfillimit të procedimit penal për referimin penal nr. {\*\*\*}, datë 26.3.2020, të dërguar nga Komisariati i Policisë Himarë, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë;

(ii) aktet e fashikullit të çështjes penale në ngarkim të shtetasve A. V. etj., të akuzuar për veprën penale “Kultivimi i narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 248/2 i Kodit Penal.

16. Në përgjigje të kërkesës së Kolegjit, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 20.10.2025, të Zv/Kryetares së Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 15.10.2025, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, janë përcjellë në Kolegj kopje të njësuara të akteve që u përkasin çështjeve penale të referuara më sipër, me të cilat janë njohur dhe palët pjesëmarrëse në proces.
17. AKSIK-ja, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 29.10.2025, ka përcjellë në Kolegj informacionin e përditësuar të dërguar nga Shërbimi Informativ i Shtetit dhe nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, informacione që janë të klasifikuara “Sekret”. Për këto informacione janë vënë në dijeni Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe vëzhguesi ndërkombëtar i ONM-së.
18. Kolegji, me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 31.10.2025, i është drejtuar përsëri Agjencisë Kombëtare të Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar me kërkesën për dërgimin e raportit të përditësuar për vlerësimin e figurës, që i përket subjektit të rivlerësimit Aurel Zarka, si dhe deklasifikimin e këtij raporti. AKSIK-ja, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 12.11.2025, ka përcjellë në Kolegj Raportin për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Aurel Zarka, të deklasifikuar plotësisht.
19. Në seancën publike të datës 13.11.2025, trupi gjykues vendosi të pranojë kërkesën e vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së për të paraqitur një gjetje lidhur me çështjen, si dhe për të marrë në formën e kërkuar nga ligji aktet që kanë të bëjnë me njoftimin e akuzës nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe vendimet e Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Aurel Zarka.
20. Vëzhguesi ndërkombëtar, me shkresën nr. {\*\*\*} ex. 2024, datë 12.01.2026, ka depozituar në Kolegj gjetjen lidhur me rrethana konkrete për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit Aurel Zarka, shoqëruar me aktet, si vijon:
  - (i) kthim përgjigje nga Prokuroria e Posaçme, për dërgimin e aktit “Kërkesë për dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. {\*\*\*} viti 2024, në ngarkim të të pandehurve Aurel Zarka etj.”;
  - (ii) kthim përgjigje nga Prokuroria e Posaçme, për dërgimin e akteve/ procesverbaleve për identifikimin e përdoruesit të kodeve *pin* dhe këqyrjen e të dhënave<sup>3</sup>;
  - (iii) kthim përgjigje nga Prokuroria e Posaçme, për dërgimin e kopjes së njësuar të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 12.11.2025, të Gjykatës e Posaçme të Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;
  - (iv) kthim përgjigje nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për dërgimin e kopjes së njësuar të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 20.05.2025, të kësaj gjykate.

---

<sup>3</sup> (i) *Procesverbal për identifikimin e përdoruesit të kodit PIN {\*\*\*}, datë 23.04.2024;* (ii) *procesverbal për këqyrjen e të dhënave, datë 23.04.2024;* (iii) *procesverbal për identifikimin e përdoruesit të kodit pin {\*\*\*}, datë 23.04.2024;* (iv) *procesverbal për identifikimin e përdoruesit të kodit PIN {\*\*\*}, datë 23.04.2024.*

21. Gjetja e paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar, si dhe aktet e sipërpërmendura u janë përcjellë nga Kolegji palëve, përkatësisht, Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë, 15.01.2026, si dhe subjektit të rivlerësimit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 15.01.2026.
22. Në seancën publike të datës 29.01. 2026, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe përfaqësuesi ligjor i subjektit të rivlerësimit paraqitën qëndrimet e tyre ndaj gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar dhe akteve të përcjella bashkë me gjetjen.
23. Në seancën e datës 10.02.2026, palët paraqitën konkluzionet përfundimtare, me anë të të cilave Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, përfundimisht, kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 779, datë 28.06.2024, të Komisionit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Aurel Zarka, pasi ka çmuar se sjelljet e konstatuara prej tij, lidhur me kriterin e figurës dhe kriterin e aftësive profesionale, së bashku me gjetjet lidhur me kriterin e pasurisë, çojnë në aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Ndërsa përfaqësuesi ligjor i subjektit të rivlerësimit, përfundimisht, kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 779, datë 28.06.2024, të Komisionit.

### ***B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik***

24. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, trupi gjykues i Kolegjit (në vijim “trupi gjykues”), pasi analizoi shkaqet e ankimit, parashtrimet dhe konkluzionet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, parashtrimet dhe konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi shqyrtoi provat e administruara në dosjen gjyqësore gjatë hetimit administrativ dhe atij gjyqësor, duke i vlerësuar këto të fundit në raport me kërkesat e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimet e mëposhtme.

#### **B.1. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë**

- *Për pasuritë e paluajtshme “apartament banimi me sipërfaqe 110,4 m<sup>2</sup>” dhe dy “garazhe” me sipërfaqe 20 m<sup>2</sup>, secili, ndodhur në Selitë, Tiranë dhe “apartament banimi me sipërfaqe 78 m<sup>2</sup>”, ndodhur në Vlorë*
25. Trupi gjykues, nga aktet në dosjen e Komisionit, për pasuritë apartament banimi dhe dy garazhe në Tiranë, si dhe për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 78 m<sup>2</sup>, ndodhur në Vlorë, konstaton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si vijon
    - 25.1. Në deklaratën vetting, ka deklaruar: (i) “Apartament në Tiranë me nr. pasurie {\*\*\*}, bashkë me garazh {\*\*\*}, bashkë me garazh me nr. pasurie {\*\*\*}, blerë me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol. Vlera: 84.000 euro. Burimi i krijimit të këtyre pasurive nga të ardhurat nga kursimet e mia dhe të bashkëshortes nga të ardhurat nga punësimi deri në momentin e blerjes së këtij apartamenti. Këto kursime janë rreth 8.000.000 (tetë milion) lekë (vërtetimet e pagave bashkëlidhur). Gjithashtu, për blerjen e apartamentit dhe garazheve është përdorur shuma prej 40.000 eurosh, e cila është përfituar nga marrëveshja e lidhur me z. H. Sh.”; (ii) “Apartament në Vlorë me nr. pasurie {\*\*\*}, blerë me kontratën me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.09.2013, në shumën 27.000 euro. Burimi i të ardhurave të kësaj pasurie rrjedh nga marrëveshja e arritur me z. H. Sh., si administrator i shoqërisë, i cili i ka marrë hua babait tim shumën prej 40.000 USD në vitin 2001, dhe më ka kthyer në vitin 2007 shumën prej 40.000

eurosh dhe apartamentin e sipërpërmendur, vërtetuar me deklaratën noteriale me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol”.

25.2. Në deklaratën para fillimit të detyrës, dorëzuar në datën 01.10.2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Apartament banimi 84 m<sup>2</sup>, në Vlorë, pranë shkollës së {\*\*\*}, blerë në vitin 2007 (me kontratë sipërmarrje, pa hipotekë) burimi i krijimit të ardhurat familjare ndër vite. Kontratë sipërmarrje me firmën “{\*\*\*}”, tetor 2012, për blerje apartament banimi me sip. 120 m<sup>2</sup>, në Komunën Farkë, Tiranë (ndërtim i papërfunduar). Me të ardhura familjare. Burimi kryesor të ardhurat nga aktiviteti profesional i babait si teknik ndërtimi nga viti 1991 deri në vitin 2002”. Subjekti i rivlerësimit ka bërë të njëjtin deklaram për këto pasuri dhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012.

26. Komisioni, në vendim, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kishin një pamundësi financiare prej (-) 158.167 lekësh për blerjen e pasurive apartament dhe 2 garazhe, në Tiranë, në vlerën 84.000 euro, dhe se mungesa e burimeve financiare të ligjshme në këtë vlerë nuk mund të ndikojë në vlerësimin përfundimtar të subjektit në lidhje me këto pasuri. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka bërë deklaram të saktë dhe të mjaftueshëm për të justifikuar blerjen e pasurive apartament dhe garazhe në vlerën 84.000 euro së bashku, në vitin 2015, sipas përcaktimeve të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

27. Për pasurinë apartament me sipërfaqe 78 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Vlorë, Komisioni ka konkluduar se nuk rezultuan problematika në lidhje me këtë pasuri dhe, mbështetur në burimin e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*, i cili i është referuar deklaratës noteriale nr. {\*\*\*}, të datës 16.06.2016, të huadhënësit H. Sh., ka vlerësuar që kjo pasuri të pasqyrohet në analizën financiare për periudhën deri në datën 06.06.2012, në shumën 27.000 euro që është blerë nga subjekti.

28. Në lidhje me shumën prej 40.000 eurosh, përfituar nga marrëveshja e lidhur midis babait të subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit H. Sh., Komisioni, në vendim, është shprehur se: “Sa më sipër, Komisioni vlerëson se nga marrja në konsideratë e të dhënave të Ministrisë së Punës dhe Shërbimeve Shoqërore të Greqisë, si dhe deklaramet nën përgjegjësi të shtetasve grekë dhe deklaramit noterial të shtetasve shqiptarë, rezultoi se babai i subjektit ka pasur mundësi për krijimin e shumës 40.000 USD (konvertuar rreth 45.300 euro), të dhëna hua në qershor të vitit 2001 shtetasit H. Sh., duke e përfshirë këtë shumë në analizën paraprake financiare të Komisionit”.

29. Në lidhje me këto pasuri, në ankimin drejtuar Kolegjit, Komisioneri Publik ka konstatuar se:

29.1. Një nga burimet kryesore të krijimit të pasurive të sipërcituara nga subjekti deklarohet se janë të ardhurat dhe përfitimet që rrjedhin nga dhënia e një huaje prej 40.000 eurosh nga babai i tij, administratorit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, z. H. Sh.. Nga kjo marrëdhënie huaje, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka përfituar: (i) *cash* vlerën prej 40.000 eurosh, të deklaruar si burim krijimi të apartamentit dhe garazheve të ndodhura në Tiranë, që përbën rreth 50% të vlerës së këtyre pasurive; si dhe (ii) apartamentin e banimit të ndodhur në Vlorë, me sipërfaqe 78 m<sup>2</sup>.

29.2. Lidhur me pasurinë apartament, me sipërfaqe 78 m<sup>2</sup>, ndodhur në Vlorë, në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si çmim blerjeje vlerën

29.400 euro, me kontratë sipërmarrje pa hipotekë dhe si burim krijimi të ardhurat familjare ndër vite, ndërsa në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar çmimin 27.000 euro, me kontratë shitblerje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.09.2013, dhe si burim krijimi marrëveshjen e arritur me z. H. Sh..

**29.3.** Për të provuar të ardhurat e realizuara nga babai i subjektit të rivlerësimit, deri në vitin 2001, që i janë dhënë hua shtetasit H. Sh., dhe në vijim janë deklaruar si burim krijimi për pasuritë objekt analize, Komisioni ka arsyetuar se babai i subjektit të rivlerësimit ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme, bazuar mbi disa deklarata noteriale të lëshuara nga shtetas shqiptarë dhe grekë në vitin 2024, si dhe mbi vërtetimet e vjetërsisë në punë, të lëshuara nga Ministria e Punës dhe Shërbimeve Shoqërore të Greqisë për periudhën 11/1995-12/1999, ku konfirmohen vetëm ditët e punës dhe jo të ardhurat e përfituara.

**29.4.** Subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij, në deklaratën noteriale të datës 21.08.2006, deklarojnë se, përveç shumës 40.000 USD, që i është dhënë hua shtetasit H. Sh., posedojnë edhe vlerën 7.000.000 lekë, që burojnë nga kursimet e punës të të ndjerit, z. T. Z. (babai i subjektit të rivlerësimit).

**29.5.** Lidhur me marrëdhënien e huas të deklaruar midis të ndjerit, babait të subjektit të rivlerësimit, dhe shtetasit H. Sh. rezulton se kontrata e huas nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.06.2001, e cila është depozituar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, vetëm në përgjigje të pyetësorit nr. 2, bie ndesh me deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep. nr. {\*\*\*} kol., datë 16.06.2016, të shtetasit H. Sh., ku ky i fundit deklaron se nuk kanë pasur një marrëveshje me shkrim në vitin 2001. Gjithashtu, po në këtë deklaratë, ky shtetas deklaron se në marrjen e huas në vitin 2001 ka vepruar në cilësinë e administratorit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK., ndërkohë që referuar ekstraktit historik të regjistrit tregtar z. H. Sh. nuk rezulton të ketë qenë administrator i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në këtë kohë<sup>4</sup>.

**29.6.** Referuar akteve të administruara në dosje, nuk rezulton që Komisioni të ketë administruar përgjigje nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë dhe nga Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1 dhe 2, në mënyrë që të kryente një hetim shterues lidhur me pasuritë e sipërcituara.

**29.7.** Sa më sipër, Komisioneri Publik konstaton se, në gjendjen që janë aktet, nuk arrin të provohet shumica e të ardhurave të pretenduara si të përfituara nga i ndjeri, babai i subjektit të rivlerësimit në shtetin grek, që deklarohet si burim krijimi për huan në shumën 40.000 USD dhe që, në vijim, deklarohet si burim kryesor krijimi për pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*.

**29.8.** Në vlerësimin e Komisionerit Publik, këto konstatime, në varësi edhe të rezultateve të hetimit të kërkuar nëpërmjet këtij ankimi, do të ndikonin në vlerësimin përfundimtar për subjektin e rivlerësimit.

**30.** Të njëjtin qëndrim mbajti edhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, gjatë gjykimit në Kolegj, në

---

<sup>4</sup> Sa i takon pasurisë “apartament me sip. 78 m<sup>2</sup>”, ndodhur në Vlorë, përveçse subjekti i rivlerësimit deklaroi vlera dhe burime të ndryshme, pretendohet si burim marrëdhënia me shtetasin H. Sh., ndërkohë që rezulton se shoqëria “{\*\*\*}” ShPK ka dhe ortakë të tjerë përveç z. H. Sh..

parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, duke u qëndruar konstatimeve të parashtruara në ankim, si më sipër.

31. Përfaqësuesi ligjor i subjektit të rivlerësimit në parashtrimet para seancës, si dhe gjatë gjykimit në Kolegj, ka shpjeguar se babai i subjektit ka siguruar nga emigrimi në shtetin grek të ardhura, të cilat, për shkak të kohës së hershme, në pamundësi objektive për sigurimin e dokumenteve të tjera për vërtetimin e tyre, duhet të vlerësohen në mënyrë proporcionale nga ana e organeve të rivlerësimit. Lidhur me konstatimet e Komisionerit Publik, për kontratën e huasë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.06.2001, përfaqësuesi ligjor ka parashtruar se këto konstatime janë jothelbësore për marrëdhënien midis palëve në kushtet kur kontrata e huasë është lidhur midis dy individëve, në të është vërtetuar qartë marrja e shumës prej 40.000 USD dhe kthimi i saj brenda një afati 5-vjeçar, së bashku me një apartament në qytetin e Vlorës, dhe huamarrësi nuk ka deklaruar se është administrator i shoqërisë tregtare, por ai ka qenë ortak kryesor i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, prej së cilës do të përdoreshin vlerat monetare të marra hua.

32. Në shqyrtim të shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik për këto pasuri, në lidhje me shumën prej 40.000 eurosh, përfituar prej marrëdhënies së huasë të babait të subjekti të rivlerësimit dhe z. H. Sh., nga aktet në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues konstaton se:

32.1. Bashkëlidhur deklaratës *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 16.06.2016, me të cilën z. H. Sh. ka deklaruar se në cilësinë e administratorit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK ka marrë hua *cash* nga i ndjeri T. Z., shumën prej 40.000 USD në vitin 2001, të cilën do ta kthente me interesa. Z. Sh. deklaroi se këtë shumë ia ka kthyer djalit të z. T. Z. në vitin 2007, pas konvertimit të bërë me mirëkuptim në shumën 40.000 euro. Në këmbim të interesave, huamarrësi prentoi një apartament 1+1, në qytetin e Vlorës, e paguar nga huamarrësi, sipas kontratës së shitjes me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 20.03.2013.

32.2. I pyetur nga Komisioni nëpërmjet pyetësorëve për këtë marrëdhënie huaje, subjekti i rivlerësimit është përgjigjur se në lidhje me këtë marrëveshje ka ardhur në dijeni në vitin 2006, pas vdekjes së babait. Në lidhje me burimin e krijimit të të ardhurave, të cilat u dhanë hua, subjekti është shprehur se ato janë krijuar nga puna e babait ndër vite si teknik ndërtimi, kryesisht në shtetin grek, ku babai i subjektit ka jetuar dhe punuar disa vite.

32.3. Për të provuar pretendimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision kontratën noteriale të huasë me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.06.2001, sipas së cilës z. T. Z. i jep hua shumën prej 40.000 USD z. H. Sh. për një periudhë 5-vjeçare dhe në përfundim të kësaj periudhe, huamarrësi detyrohet t'i kthejë shumën prej 40.000 USD dhe një apartament në qytetin e Vlorës, jo më të vogël se 60 m<sup>2</sup>.

32.4. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka sjellë deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.08.2006, lëshuar nga trashëgimtarët e të ndjerit T. Z., subjekti, nëna dhe motra e tij, të cilët kanë deklaruar se: “Duke qenë se huaja dhe interesat, lindur nga të drejtat e trashëgimlënësit tonë, të ndjerit T. Z., ende nuk janë kthyer nga huamarrësi, autorizojmë djalin dhe vëllain tonë, shtetasin Aurel T. Zarka që, në lidhje me këto të drejta dhe detyrime të shtetasit H. Sh. që rrjedhin nga marrëdhënia e huamarrjes, të përdorë

*shumën e dhënë hua nga i ndjeri, duke pasur të drejtë ta arkëtojë atë dhe interesat përkatëse, si dhe të përdorë lirisht dhe pa kufizim të gjitha të drejtat që mund të vijnë nga kjo huadhënie”.*

**32.5.** Për të vërtetuar të ardhurat e babait, të cilat kanë shërbyer për dhënien e huas në shumën 40.000 USD, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision dokumentacionin:

**32.5.1.** Deklaratë përgjegjësie të shtetasit grek N. A. (përkthyer në shqip, noterizuar dhe me vulë apostile), i cili deklaron se gjatë viteve 1998-2001, z. T. Z. ka punuar në shoqërinë “{\*\*\*}” ShA, si drejtor teknik dhe i pastrimit, me pagesë 180.000 DRH në muaj;

**32.5.2.** Deklaratë përgjegjësie të shtetasit grek E. P. (përkthyer në shqip, noterizuar dhe me vulë apostile), i cili deklaron se gjatë 3-vjeçarit 1993-1996, z. T. Z. ka punuar në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, si teknik me pagesë ditore 8.000 DRH;

**32.5.3.** Vërtetim i vjetërsisë në punë, nga Ministria e Punës dhe Shërbimeve Shoqërore të Greqisë, datë printimi 19.02.2024 (përkthyer në shqip dhe noterizuar), në të cilin vërtetohet se z. T. Z., është i siguar si punonjës për 263 ditë sigurim për periudhën nëntor 1995-dhjetor 1996, pranë punëdhënësit “{\*\*\*}”;

**32.5.4.** Vërtetim i vjetërsisë në punë, nga Ministria e Punës dhe Shërbimeve Shoqërore të Greqisë, datë printimi 19.02.2024 (përkthyer dhe noterizuar), në të cilin vërtetohet se z. T. Z., është i siguar si punonjës për 363 ditë sigurim për periudhën janar 1997-mars 1998, pranë punëdhënësit {\*\*\*};

**32.5.5.** Vërtetim i vjetërsisë në punë, nga Ministria e Punës dhe Shërbimeve Shoqërore të Greqisë, datë printimi 19.02.2024 (përkthyer dhe noterizuar), në të cilin vërtetohet se z. T. Z. është i siguar si punonjës për 410 ditë sigurim për periudhën prill 1998-dhjetor 1999, pranë punëdhënësit {\*\*\*};

**32.5.6.** Deklaratë noteriale, datë 05.03.2024, të shtetasve M. M. dhe M. M., në të cilën deklarohet se në vitet 1996-1998, kanë punuar në shtetin grek me shtetasin T. Z. dhe paga ditore varionte nga 10.000-12.000 DRH.

**33.** Nga të dhënat e akteve të mësipërme, trupi gjykues, *së pari* vëren se, ashtu si ka konstatuar dhe Komisioneri Publik në ankim ka mospërputhje midis deklaramit të bërë nga huamarrësi H. Sh. në deklaratën noteriale nr. {\*\*\*}, datë 16.06.2016, në të cilën ai deklaron *se duke vlerësuar korrektësinë e marrëdhënies, për shumën 40.000 USD nuk bëme marrëveshje me shkrim por ramë dakord verbalisht* dhe aktit të sjellë nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, kontratës noteriale të huasë me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.06.2001, sipas së cilës z. T. Z. i jep hua shumën prej 40.000 USD z. H. Sh..

**34.** Gjithashtu, trupi gjykues vëren se ka mospërputhje në deklaramet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me vlerën dhe burimet për krijimin e pasurisë apartament, me sipërfaqe 78 m<sup>2</sup>, ndodhur në Vlorë, pasi në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2012, si dhe deklaratën periodike të këtij viti, ai deklaron si çmim blerjeje vlerën 29.400 euro, me kontratë sipërmarrje pa hipotekë dhe si burim krijimi të ardhurat familjare ndër vite, ndërsa në deklaratën *vetting*, deklaron çmimin 27.000 euro, me kontratë shitblerje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.09.2013, dhe si burim krijimi marrëveshjen e arritur me z. H. Sh.. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, lidhur me diferencat në çmimet e deklaruar, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se *ndryshimi në çmim vjen për shkak të faktit se sipërfaqja e banimit e kontraktuar në vitin 2007*

*ishte më e madhe (84 m<sup>2</sup>) sesa sipërfaqja e banimit e kontraktuar përfundimisht në vitin 2013 prej 78 m<sup>2</sup>, sipas certifikatës së pronësisë përkatëse.*

35. Për sa u përket të ardhurave të babait të subjektit të rivlerësimit nga emigrimi, trupi gjykues vëren se dokumentacioni i lëshuar nga Ministria e Punës dhe Shërbimeve Shoqërore e Greqisë ka të dhëna vetëm për punësimin dhe për ditët e punës, për të cilat është siguruar babai i subjektit të rivlerësimit për periudhën 1995-1999, por pa përcaktuar vlerën e të ardhurave të përfituara nga ky punësim. Vihet re, gjithashtu, se punëdhënësit e cituar në këto dokumente zyrtare nuk janë të njëjtë me punëdhënësit që kanë lëshuar deklaratat noteriale për punësimin e babait të subjektit në vitet 1993-1996 dhe 1998-2001.
36. Komisioni, bazuar në deklaratat e dy shtetasve grekë N. A. dhe E. P., deklaratës noteriale të lëshuar nga vëllezërit M. dhe vërtetimeve të lëshuara nga Ministria e Punës dhe Shërbimeve Shoqërore të Greqisë, ka kryer një përlllogaritje për të ardhurat e përfituara nga babai i subjektit në emigracion. Në pamundësi të pasjes së një vlere të saktë të të ardhurave të përfituara nga babai i subjektit në shtetin grek për periudhën 1993 – qershor 2001, Komisioni ka konsideruar si vlera të dhënat e marra nga deklaratimet nën përgjegjësi të shtetasve grekë dhe deklaratimit noterial të shtetasve shqiptarë. Sa më sipër, Komisioni, nga marrja në konsideratë e të dhënave të Ministrisë së Punës dhe Shërbimeve Shoqërore të Greqisë, për periudhat e punësimit 1995-1999, si dhe deklaratimet nën përgjegjësi të shtetasve grekë dhe deklaratimit noterial të shtetasve shqiptarë, ka konkluduar se babai i subjektit të rivlerësimit ka pasur mundësi për krijimin e shumës 40.000 USD (e konvertuar rreth 45.300 euro), të dhënë hua në qershor të vitit 2001 shtetasit H. Sh..
37. Trupi gjykues, nga verifikimi i akteve në dosjen e Komisionit, konstaton se në vërtetimet e lëshuara nga institucionet zyrtare nuk ka të dhëna për vlerën e saktë të të ardhurave të siguruar nga punësimi i babait të subjektit të rivlerësimit në shtetin grek. Dokumentacioni i paraqitur nga Ministria e Punës dhe Shërbimeve Shoqërore të Greqisë jep vetëm ditët e punës duke mos specifikuar asnjë vlerë të të ardhurave të përfituara. Deklaratat noteriale të shtetasve grekë dhe shqiptarë, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, përmbajnë të dhëna të cilat nuk përputhen me të dhënat e dokumentacionit të paraqitur nga Ministria e Punës dhe, për rrjedhojë, nuk mund të përcaktohet periudha e punësimit dhe të ardhurat e përfituara. Një tjetër problematikë që konstatohet në analizën e Komisionit është edhe përlllogaritja e shpenzimeve të jetesës në shtetin grek për periudhën 1994 - qershor 2001, ndërkohë që të ardhurat në shumën 24.500 euro janë përlllogaritur për periudhën 1993 - qershor 2001. Komisioni citon në vendim se kjo përlllogaritje është kryer sipas të dhënave statistikore të shtetit grek, por pa referuar një burim zyrtar.
38. Për sa më sipër, në Kolegj, u krye një përlllogaritje hipotetike e të ardhurave të mundshme që babai i subjektit të rivlerësimit ka përfituar në shtetin grek, duke marrë për bazë të dhënat e paraqitura nga Ministria e Punës dhe Shërbimeve Shoqërore për periudhat e punësimit, ndërsa për vlerën e përfituar ditore dhe mujore të të ardhurave, të dhënat e deklaratave të shtetasve grekë. Nga të dhënat e publikuara nga EUROSTAT<sup>5</sup>, për shpenzimet e jetesës për një person në prag varfërie, rezulton se shpenzimet e jetesës për periudhën nëntor 1995 - dhjetor 1999<sup>6</sup>

<sup>5</sup> [https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ilc\\_li01\\_custom\\_15262442/default/table?lang=en](https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ilc_li01_custom_15262442/default/table?lang=en)

<sup>6</sup> Periudha për të cilën ka qenë i siguruar babai i subjektit të rivlerësimit, sipas vërtetimeve të Ministrisë së Punës dhe Shërbimeve Shoqërore të Greqisë.

kanë qenë në shumën 14.992 euro, të konvertuara në lekë me kursin e publikuar nga Banka e Shqipërisë, në shumën 2.203.200 lekë. Nga diferenca mes të ardhurave të mundshme të përfituara në shtetin grek dhe shpenzimeve të jetesës, rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit do të mund të kursente shumën prej 2.473.813 lekësh, e cila është e pamjaftueshme për t'i dhënë shtetasit H. Sh. huanë në shumën 40.000 USD në vitin 2001. Në këto kushte, trupi gjykues konkludon se huaja prej 40.000 USD, e pretenduar se është dhënë nga babai i subjektit të rivlerësimit në vitin 2001 dhe kthyer nga huamarrësi në vitin 2007, nuk mund të ketë shërbyer si burim për krijimin e pasurive apartament banimi dhe dy garazhe në Tiranë dhe apartament banimi në Vlorë.

39. Në Kolegj, në kuadër të arritjes së një vendimmarrjeje sa më objektive, u krye analiza lidhur me verifikimin e ligjshmërisë së burimeve financiare të krijimit të pasurive nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2012, për periudhën nga data e emërimit në detyrë, më 06.06.2012, deri në datën 31.12.2012, duke konsideruar se kursimet nga të ardhurat e mundshme nga emigracioni të babait të subjektit, në vlerën prej 2.473.813 lekësh, janë përdorur për apartamentin e përfituar në Vlorë, në vitin 2007 në vlerën 27.000 euro. Nga kjo analizë rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij nuk kanë pasur mundësi të krijonin me burime financiare të ligjshme pasuritë apartament dhe dy garazhe në qytetin e Tiranës, për një diferencë negative prej (-) 5.712.148 lekësh.
40. Në konkluzion, për pasuritë apartament banimi me sipërfaqe 110,4 m<sup>2</sup> dhe dy garazhe me sipërfaqe 20 m<sup>2</sup>, secili, në Selitë, Tiranë dhe apartament banimi me sipërfaqe 78 m<sup>2</sup>, në Vlorë, trupi gjykues e gjeti të bazuar pretendimin e Komisionerit Publik dhe të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e këtyre pasurive, pasi nuk provohet shuma e të ardhurave të pretenduara si të përfituara nga babai i subjektit të rivlerësimit në shtetin grek, që deklarohet si burim krijimi për huanë në shumën 40.000 USD, e deklaruar në vijim nga subjekti i rivlerësimit, gjatë procesit të rivlerësimit, si burim kryesor krijimi për këto pasuri.
41. Komisioneri Publik, në ankim, konstaton se një nga burimet e krijimit të likuiditeteve në Fondin e Investimit në Raiffeisen Invest, me vlerë 9.118.267 lekë, janë të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit të banimit me sipërfaqe 59 m<sup>2</sup>, të ndodhur në bulevardin “{\*\*\*}”, Tiranë, në datën 31.08.2008, në vlerën 4.318.800 lekë. Nga aktet e administruara në dosje të Komisionit ka rezultuar se shtetasi N. I. e ka blerë këtë apartament në datën 14.05.2004, në vlerën 3.450.000 lekë, dhe rreth tre vjet më vonë ia ka shitur subjektit të rivlerësimit, në vlerën 2.000.000 lekë. Ndërsa subjekti i rivlerësimit e ka shitur këtë apartament në datën 31.10.2008, gati një vit e gjysmë më vonë, më shumë se dyfishi i çmimit të blerjes, në shumën 4.318.800 lekë.
42. Sa më sipër, Komisioneri Publik vëren se subjekti i rivlerësimit duket të jetë në kushtet e një veprimi juridik fiktiv/të simuluar dhe të ardhurat e përfituara nga transaksionet për shitblerjen e apartamentit të banimit me sipërfaqe 59 m<sup>2</sup>, të ndodhur në bulevardin “{\*\*\*}”, afektojnë burimin e krijimit të pasurisë Fond Investimi në Raiffeisen Invest me vlerë 9.118.267 lekë, dhe duhen marrë në konsideratë nga Kolegji në vlerësim tërësor, në varësi edhe të rezultateve të hetimit të kërkuar nëpërmjet këtij ankimi.

43. Komisioni, në vendim, bazuar në dokumentacionin e administruar për shitblerjen e apartamentit, si dhe në pagesën e detyrimit tatimor nga kalimi i të drejtës së pronësisë për këtë pasuri të paluajtshme, ka konkluduar se të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, duke i përfshirë të plota në analizën financiare për mundësinë e subjektit të rivlerësimit për krijimin e Fondit të Investimit në Raiffeisen Bank.
44. Në analizë të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues, nga aktet e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, konstatoi se:
- 44.1. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar krijimin e një fond investimi pranë Raiffeisen Bank, në datën 29.01.2013, në vlerën 9.118.266,98 lekë, me burim krijimi shitjen e një sipërfaqeje toke në vitin 2004, në vlerën 1.500.000 lekë, shitjen e një sipërfaqeje tjetër toke në vitin 2006 në vlerën 2.000.000 lekë, shitjen e një shtëpie në qytetin e Fierit në vitin 2006, në vlerën 1.900.000 lekë, shitjen e një apartamenti në qytetin e Tiranës në vlerën 4.318.800 lekë, si dhe shitjen e tre sipërfaqeve të tokës, në vlerat 227.000 lekë, 340.000 dhe 227.000 lekë secila.
- 44.2. Në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës në vitin 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një llogari bankare në emër të tij në shumën 7.500.000 lekë në Raiffeisen Bank, me burim kryesor shitje pasuri të patundshme të familjes (toka dhe shtëpia në Fier për vlerën 6.000.000 lekë), si dhe një apartamenti në Tiranë, blerë në vitin 2006, në vlerën 2.000.000 lekë, dhe shitur në vitin 2008, në vlerën 4.300.000 lekë.
- 44.3. Në deklaratat e pasurisë të viteve 2013-2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vlerat e llogarisë shtuar nga interesat bankare të përfituara prej saj, me një vlerë prej 9.106.000 lekësh në fund të vitit 2016.
- 44.4. Bashkëlidhur deklaratës *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vërtetimin nr. {\*\*\*}, datë 26.01.2017, të Raiffeisen Invest (për periudhën 01.03.2015 – 24.01.2017), në të cilin rezulton se vlera e kuotave në datën 24.01.2017 është 9.118.267 lekë.
- 44.5. Bazuar në kontratën e shitjes me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 13.01.2007, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shtetasi N. I. apartamentin me sipërfaqe 59 m<sup>2</sup>, me adresë Blv. “{\*\*\*}”, pall. {\*\*\*}, shk. {\*\*\*}, k. {\*\*\*}, në Tiranë, për vlerën 2.000.000 lekë, likuidimi i së cilës është bërë jashtë zyrës noteriale.
- 44.6. Subjekti i rivlerësimit u ka shitur blerësve M. dhe A. P. apartamentin me sipërfaqe 59 m<sup>2</sup>, në Blv. “{\*\*\*}”, pallati {\*\*\*}, shk. {\*\*\*}, k. {\*\*\*}, ap. {\*\*\*}, në shumën 4.318.800 lekë, sipas kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., të datës 31.10.2008. Sipas kësaj kontrate, pagesa e çmimit të blerjes së apartamentit është likuiduar para nënshkrimit të kontratës, jashtë zyrës noteriale.
45. Në dokumentacionin e administruar nga Komisioni, referuar të dhënave nga Raiffeisen Bank rezulton se në datën 07.11.2008, është depozituar *cash* nga subjekti i rivlerësimit në llogarinë në emër të tij në këtë bankë, shuma 5.000.000 lekë, me përshkrim “*derdhje në llogari nga shitja e apartamentit*”. Sipas mandatit të datës 10.11.2008, të Credins Bank, subjekti i rivlerësimit ka paguar, në *cash*, tatimin për kontratën e shitjes së apartamentit të datës 31.10.2008, në vlerën 213.800 lekë. Nga këto të dhëna, trupi gjykues vëren se vlera 5.000.000

lekë e depozituar nga subjekti i rivlerësimit në llogarinë e tij në Raiffeisen Bank është më e lartë se vlera 4.318.800, e përfituar nga shitja e apartamentit, duke konsideruar se brenda vlerës së shitjes është dhe pagesa e detyrimit të tatimit mbi të ardhurat për kalimin e të drejtës së pronësisë.

46. I pyetur nga Komisioni nëpërmjet pyetësorëve, në lidhje me vlerën e ulët të blerjes së këtij apartamenti në vitin 2007 dhe arsyen se përse pas pak kohësh u shit në një vlerë shumë më të lartë, subjekti i rivlerësimit është përgjigjur se çmimi i këtij apartamenti ka qenë i ulët, pasi në katin e poshtëm ushtronte aktivitetin një furrë buke, e cila shkaktonte zhurma dhe shqetësim për banorët e pallatit. Si pasojë e ankesave nga banorët ky aktivitet u mbyll dhe, për këtë arsye, edhe vlera e apartamentit u rrit. Të njëjtat shpjegime ka dhënë përfaqësuesi ligjor i subjektit të rivlerësimit dhe në parashtrimet, si dhe në seancat gjyqësore të zhvilluara në Kolegj.
47. Nga verifikimi i akteve, trupi gjykues konstaton se Komisioni nuk ka kryer asnjë hetim në lidhje me mundësinë e veprimeve të mundshme fiktive për përfitimin dhe shitjen e këtij apartamenti, por ka konkluduar bazuar në dokumentacionin për shitblerjen e apartamentit, si dhe pagesën e detyrimit tatimor për kalimin e të drejtës së pronësisë. Duke iu referuar të dhënave të Entit Kombëtar të Banesave për vlerat mesatare të tregut të lirë të apartamenteve për Tiranën, për vitin 2007, rezulton se vlera e apartamentit do të ishte 5.723.000 lekë (97.000 lekë/m<sup>2</sup> x 59 m<sup>2</sup>), ndërkohë që subjekti i rivlerësimit e ka blerë në vlerën 2.000.000 lekë. Nga shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit mbi arsyet e blerjes së apartamentit me një çmim shumë më të ulët se vlera e tregut dhe shitjes më pas të tij më shumë se dyfishi i çmimit të blerjes, të paprovuara me ndonjë akt apo rrethanë tjetër objektive prej tij, trupi gjykues krijon bindjen se nuk provohet vlera e deklaruar nga subjekti për blerjen e apartamentit në fjalë në vitin 2007. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, edhe pse bazuar në ankimin e ngritur nga Komisioneri Publik, gjatë gjykimit në Kolegj, në zbatim të nenit Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, kishte barrën e provës për të justifikuar blerjen e apartamentit dukshëm nën vlerën e tregut, nuk arriti ta përmbysë atë dhe të qartësojë situatën lidhur me transaksionet për shitblerjen e apartamentit në fjalë. Veprimet e subjektit të rivlerësimit dhe pasojat financiare që kanë sjellë, duket se kanë pasur për qëllim justifikimin e të ardhurave, të cilat kanë shërbyer më pas si një nga burimet për krijimin e fondit të investimit në Raiffeisen Bank.
48. Për rrjedhojë, për pasurinë Fond Investimi në Raiffeisen Bank, me vlerë 9.118.267 lekë, trupi gjykues çmon se, në kushtet kur të ardhurat nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 59 m<sup>2</sup>, në Tiranë, janë deklaruar si një nga burimet e krijimit të këtyre likuiditeteve, dhe se subjekti i rivlerësimit duket se ka kryer veprime juridike fiktive/të stimuluar për blerjen e apartamentit me çmim shumë më të ulët dhe shitjen më pas me çmim dyfish më të lartë, këto transaksione kanë afektuar burimin e krijimit të kësaj pasurie.
49. Bazuar në konkluzionet si më sipër referuar, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, dhe ky konkluzion merret në konsideratë së bashku me shkaqet e tjera të ankimit, në një vlerësim tërësor, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

## **B.2. Për kriterin e kontrollit të figurës**

50. Komisioni, në vendimin objekt shqyrtimi, bazuar në të dhënat e Raportit të AKSIK-së për përshtatshmëri në detyrë të subjektit të rivlerësimit, si dhe pas kryerjes së hetimit administrativ, ka arritur në përfundimin se: [...] *subjekti i rivlerësimit Aurel Zarka ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës "b", të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.*
51. Komisioneri Publik, bazuar në rekomandimin e ONM-së, në ankim, lidhur me kriterin e vlerësimit të figurës ka kërkuar që referuar rrethanave të reja, për sa kohë që procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Zarka, nuk ka përfunduar, me qëllim përmbylljen me objektivitet të kontrollit të figurës sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës e të listuara në kreun V të ligjit nr. 84/2016, Kolegji duhet të çelë hetimin gjyqësor dhe t'i kërkojë AKSIK-së të përditësojë raportin për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, në përputhje me detyrimet që ky institucion ka, në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016.
52. Ky kërkim i Komisionerit Publik është konfirmuar dhe nga përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, i cili në parashtrimet para seancës, si dhe në seancën e datës 06.10.2005, referuar dokumentit bashkëlidhur Rekomandimit të ONM-së, datë 8.10.2024, konkretisht "Njoftimit për shtyp të datës 30.7.2024", përcjellë nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, lidhur me procedimin penal me nr. {\*\*\*}, datë 07.02.2024, në kuadër të të cilit u dha vendimi i aksesuar nr. {\*\*\*} akti, datë 31.07.2024 (për caktimin e masave të sigurimit personal) nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka vlerësuar se rezultojnë shkaqe të bazuara për të kërkuar nga AKSIK përditësimin e Raportit për të realizuar procedurën e kontrollit të figurës sipas parashikimit të nenit 39, i ndërlidhur me kërkesat e përgjithshme të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016.
53. Pas kërkesës së Kolegjit, AKSIK-ja në datën 12.11.2025, ka përcjellë Raportin nr. {\*\*\*} prot., datë 11.11.2025, për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Aurel Zarka, të deklasifikuar plotësisht. Sipas këtij Raporti, Grupi i Punës, nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit Aurel Zarka, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në *papërshtatshmëri* për vazhdimin e detyrës.
54. Konkluzionet e Raportit të AKSIK-së janë bazuar në informacionet e ardhura nga institucionet e verifikimit, sipas të cilave:
- *Gjatë periudhës në të cilën z. Zarka ushtronte detyrën si prokuror, dyshohet se është përfshirë në veprime korruptive në vitet 2019-2024;*
  - *Në lidhje me subjektin në fjalë, jemi informuar edhe mbi të dhënat që disponohen për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e ushtrimit të ndikimit të paligjshëm, me qëllim lehtësimin e pozitës së të pandehurit;*
  - *Institucionet verifikuese e kanë përmendur z. Aurel Zarka në katër informacione, të cilat janë përcjellë në SPAK;*
  - *Për subjektin e rivlerësimit Aurel T. Zarka grupi i Punës thelloi më tej verifikimet duke iu drejtuar autoriteteve verifikuese për të dhëna të reja;*
  - *Nga autoritetet verifikuese, përveç të tjerave, bëhet me dije se subjekti Zarka është përfshirë në shpërdorim detyre, ku sinjalizohet se disa herë ka shfaqur predispozitën për të mbyllur*

*procedimin penal në ngarkim të një shtetasi, për veprën penale të pastrimit të produktit të veprës penale, kundrejt ndërveprimit korruptiv;*

*- Institucionet verifikuese kanë vënë në dijeni se në ngarkim të z. Zarka ka të dhëna, të siguruar së fundmi, të lidhura me ushtrimin e ndikimit të paligjshëm, në mënyrë të vazhdueshme ndaj punonjësve të veçantë të nivelit drejtues e vendimmarrës, me qëllim favorizimin e një shtetasi në fushën e ndërtimit.*

*- Nga institucionet e verifikimit është vënë në dijeni se subjekti Zarka është arrestuar për ekzekutimin e vendimit nr. {\*\*\*}, dt. 28.07.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila ka vendosur masën e sigurisë “Arrest me burg”, për veprat penale “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë” “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, të kryera në bashkëpunim.*

55. Në vlerësim të të dhënave të disponuara nga autoritetet verifikuese për subjektin e rivlerësimit Aurel Zarka, Grupi i Punës ka arsyetuar të merren parasysh elementet që evidentojnë përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme në format e korrupsionit gjatë ushtrimit të detyrës, pasi në frymën e ligjit nr. 84/2016 vlerësohet se integriteti profesional është përcaktues për pastërtinë e figurës së subjekteve të rivlerësimit.
56. Përfaqësuesi ligjor i subjektit të rivlerësimit në seancën e datës 29.01.2026, ka prapësuar se të gjithë gjetjet apo të dhënat e reja të referuara në raportin e përditësuar të AKSIK-së burojnë vetëm nga procedimi penal nr. {\*\*\*/2024 i Prokurorisë së Posaçme, i bazuar mbi akte dhe informacione, të cilat kanë ardhur nga autoritetet franceze dhe janë administruar në atë proces penal nga Prokuroria e Posaçme, siç rezultojnë nga aktet, pa asnjë përfshirje, informacion apo referim tjetër nga institucionet verifikuese në Republikën e Shqipërisë, siç pretendohet formalisht në raportin e përditësuar nga AKSIK.
57. Trupi gjykues konstaton se nuk është i bazuar pretendimi i mësipërm i përfaqësuesit ligjor të subjektit të rivlerësimit, pasi nga përmbajtja e raportit të AKSIK-së, rezultojnë të ketë referime edhe për informacione të tjera nga autoritetet verifikuese, që nuk kanë lidhje me të dhënat që kanë rezultuar nga hetimi i kryer nga Prokuroria e Posaçme në kuadër të procedimit penal nr. {\*\*\*/2024. Konkretisht, në raport referohen dhe të dhëna, të dala nga verifikimet e reja, për ushtrimin e ndikimit të paligjshëm në mënyrë të vazhdueshme ndaj punonjësve të nivelit të veçantë vendimmarrës, me qëllim favorizimin e një shtetasi në fushën e ndërtimit.
58. Në përfundim, trupi gjykues, pasi shqyrtoi Raportin nr. {\*\*\*} prot., datë 11.11.2025, të Agjencisë Kombëtare të Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Aurel Zarka, të deklasifikuar plotësisht, sipas së cilit Grupi i Punës ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës, dhe pas analizimit të tij, duke ndarë të njëjtin qëndrim me Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, vendosi që të dhënat e siguruar nga autoritetet verifikuese t'i çmojë në një vlerësim tërësor të çështjes, në raport dhe me konkluzionet e arritura për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.

### **B.3. Gjetja e paraqitur nga vëzhguesi i ONM-së pas ankimit të ushtruar nga Komisioneri Publik**

59. Vëzhguesi ndërkombëtar, me shkresën nr. {\*\*\*} ex. 2024, datë 12.01.2026, ka depozituar në Kolegj gjetjen lidhur me rrethana konkrete për çështjen, që i përket subjektit të rivlerësimit Aurel Zarka, të shoqëruar me disa akte mbështetëse.
60. Vëzhguesi ndërkombëtar, bazuar në gjetjet e konstatuara nga hetimi penal i Prokurorisë së Posaçme dhe provat e dala nga komunikimet e koduara SkyECC, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte sistematike dhe të përsëritura me tre të pandehurit e tjerë në lidhje me trajtimin e procedimeve penale konkrete, si dhe është konfirmuar se ka përdorur telefona të koduar SkyECC. Ky grup provash, në tërësinë e tyre, tregon një model sjelljeje që cenon rëndë pavarësinë, integritetin dhe besueshmërinë e një prokurori. Pavarësisht nga rezultati përfundimtar i procedimit penal, vetë fakti i përfshirjes së z. Zarka në komunikime të tilla të koduara dhe të papërshtatshme, që lidhen me akte konkrete hetimore dhe gjyqësore, mjaftojnë për të konstatuar cenim të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe për efekt të procesit të rivlerësimit papërshtatshëm të tij etike dhe profesionale për ushtrimin e detyrës së prokurorit. Sipas vëzhguesit, ka indicie serioze që sjellja e subjektit të rivlerësimit është në kundërshtim me vlerat themelore që priten nga një magjistrat, siç përcaktohet nga neni 3, pika 5<sup>7</sup> dhe neni 75 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimet ndërkombëtare që rregullojnë sjelljen e magistratëve si brenda ashtu edhe jashtë gjyqësorit. Këtu përfshihen parime të tilla si paanshmëria, integriteti dhe shmangia e konflikteve të interesit, të cilat janë thelbësore për të ruajtur besimin dhe besueshmërinë e sistemit gjyqësor.
61. Bazuar në provat e cituara më sipër, vëzhguesi ndërkombëtar ka arritur në konkluzionin se pavarësisht ndonjë dënimi penal përfundimtar, pjesëmarrja e subjektit të rivlerësimit në komunikimet SkyECC, negocimi i mënyrës së përfundimit të procedimit penal dhe diskutimi i shifrave të paligjshme financiare janë, në vetvete, të mjaftueshme për të konstatuar papërshtatshëm të tij etike dhe profesionale për vazhdimin e ushtrimit të funksionit të prokurorit. Sjellja e subjektit të rivlerësimit komprometon/cenon në mënyrë të pakthyeshme besimin e publikut në sistemin e drejtësisë dhe tregon mungesë pavarësie, ekspozim të shtuar ndaj rreziqeve të korrupsionit dhe gatishmëri për të abuzuar me autoritetin e prokurorit për interesa personale, duke bërë të arsyeshëm zbatimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
62. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në qëndrimin e mbajtur në seancën e datës 29.01.2026, referuar gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar, si dhe akteve të administruara në Kolegj, konkretisht: (i) *kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. {\*\*\*} viti 2024*; (ii) *procesverbaleve për identifikimin e përdoruesit të kodeve të ndryshme PIN të atribuuar z. Aurel Zarka*; (iii) *vendimit nr. {\*\*\*}, datë 12.11.2025, të Gjykatës e Posaçme të Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar*; (iv) *vendimit nr. {\*\*\*}, datë 20.05.2025, të Gjykatës e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar* -- ka vlerësuar se, bazuar në gjetjet e konstatuara nga hetimi penal i Prokurorisë së Posaçme dhe provat e dala, është konfirmuar se z. Zarka ka përdorur telefona të platformës së aplikacionit të koduar SkyECC. Nga komunikimet e koduara në platformën SkyECC konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte sistematike dhe të përsëritura me

---

<sup>7</sup> Sjellja e magistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, profesioni ligjor dhe palëve në proces.

shtetasit E. D., A.V. dhe avokatin mbrojtës R. Ç., në lidhje me trajtimin e procedimeve penale konkrete.

63. Sipas Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, nga përmbajtja e komunikimeve, duket se subjekti i rivlerësimit ka vepruar si ndërmjetës midis palëve të interesuara dhe funksionarëve të gjyqësorit dhe prokurorisë, duke marrë pjesë në negocimin e mënyrës së përfundimit të procedimit penal. Këto rrethana tregojnë një model sjelljeje që cenon rëndë pavarësinë, integritetin dhe besueshmërinë e një prokurori. Vetë fakti i përfshirjes së z. Zarka në komunikime të tilla të koduara dhe të papërshtatshme që lidhen me akte konkrete hetimore dhe gjyqësore, mjafton për të konstatuar cenim të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe për efekt të procesit të rivlerësimit, papërshtatshmërinë e tij etike dhe profesionale për ushtrimin e detyrës së prokurorit.
64. Përfaqësuesi ligjor i subjektit të rivlerësimit, në qëndrimin e mbajtur ndaj gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar, ka parashtruar se kjo gjetje rezulton të jetë bazuar mbi aktet e dërguara nga Prokuroria e Posaçme dhe gjykatat, pjesë të procedimit penal nr. {\*\*\*/2025, në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Aurel Zarka. Vëzhguesi ndërkombëtar referon fakte dhe rrethana të parashtruara në vendimet gjyqësore nr. {\*\*\*}, datë 12.11.2025, të Gjykatës e Posaçme të Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe nr. {\*\*\*}, datë 20.05.2025, të Gjykatës e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Ndërkohë rezulton se kundër vendimit nr. {\*\*\*}, datë 12.11.2025, të Gjykatës së Posaçme të Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, Kolegji Penal i së cilës në datën 15.01.2025 ka vendosur prishjen e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 12.11.2025, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues. Për pasojë, aktualisht nuk ka një vendim të formës së prerë për këtë çështje penale, por vetëm një vendim të gjykatës së shkallës së parë, i ankimuar nga mbrojtja e të pandehurit Aurel Zarka, i cili kërkon të deklarohet i pafajshëm.
65. Sipas përfaqësuesit ligjor të subjektit të rivlerësimit, gjetjet faktike të cilësuara nga vëzhguesi ndërkombëtar bazohen ekskluzivisht në aktet e prokurorisë dhe në vendimet e gjykatave, të cilat janë jo të formës së prerë dhe nuk mund të pretendohen si fakte të provuara në procesin e rivlerësimit kalimtar dhe, vërtetësia e tyre ose jo varet në mënyrë të pashmangshme nga procesi penal i cili është në zhvillim e sipër. Në mungesë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, asnjë nga gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar nuk mund të cilësohet si fakt i konfirmuar. Gjithashtu, theksohet se nuk janë vërtetuar kontaktet sistematike dhe të përsëritura të subjektit të rivlerësimit me personat e tjerë të proceduar, si dhe nuk është konfirmuar se ai ka përdorur telefona të koduar SkyECC. Për këtë arsye, konstatimi i vëzhguesit ndërkombëtar se pavarësisht nëse ngarkohet me përgjegjësi penale, vetë fakti i përfshirjes në komunikime të fshehta të koduara, në vetvete, është i papajtueshëm me rolin e prokurorit, është i paprovuar në rastin konkret, pasi Aurel Zarka ka mohuar përdorimin dhe përfshirjen e tij në këto komunikime, dhe ky fakt provohet vetëm nga një vendim i formës së prerë të gjykatës, i cili aktualisht nuk ekziston.
66. Në përfundim, përfaqësuesi ligjor i subjektit të rivlerësimit ka kërkuar që, për sa kohë që faktet e cituara nuk janë të provuara sipas ligjit dhe subjekti i rivlerësimit është i pafajshëm, Kolegji

të mos pranojë gjetjen e paraqitur në shkresën nr. {\*\*\*} prot. extra 2024, datë 13.01.2026, të vëzhguesit ndërkombëtar.

67. Në analizë të sa paraqitur më sipër, trupi gjykues vëren se gjetja e paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar është bazuar në gjetjet e dala nga hetimi penal i Prokurorisë së Posaçme dhe nga komunikimet e koduara SkyECC, fakte dhe prova, të cilat janë shqyrtuar nga gjykatat pas dërgimit të kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. {\*\*\*}/2024. Pas shqyrtimit gjyqësor lidhur me këtë çështje penale, gjykatat kanë disponuar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 20.05.2025, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe vendimin nr. {\*\*\*}, datë 12.11.2025, të Gjykatës së Posaçme të Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, sipas së cilave subjekti i rivlerësimit Aurel Zarka është deklaruar fajtor për kryerjen e disa veprave penale. Ndërkohë, rezulton se pas paraqitjes së gjetjes nga vëzhguesi ndërkombëtar, në datën 12.01.2026, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 15.01.2026, ka vendosur: *Prishjen e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 12.11.2025, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues.*
68. Trupi gjykues, bazuar në të dhënat që rezultojnë nga aktet e sipërpërmendura, duke konstatuar se në gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar theksohet se *fokusi nuk është të konstatohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kryer ose jo vepra penale, duke qenë se ky fakt mbetet ekskluzivisht në vlerësimin e gjykatave penale kompetente, por të konstatohet nëse rrethanat dhe provat e çështjes qëndrojnë për marrjen e një mase disiplinore për qëllim të procedurës së rivlerësimit kalimtar, vlerëson se gjetja e vëzhguesit ndërkombëtar dëshmon për fakte e rrethana ligjore, nën dritën e nenit 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016<sup>8</sup>. Si rrjedhojë, përmbajtja e gjetjes së datës 12.01.2026, depozituar nga vëzhguesi ndërkombëtar, u mor në shqyrtim dhe është pjesë integrale e analizës së trupit gjykues të Kolegjit.*

#### **B.4. Lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale**

69. Për sa i përket kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale në ankimin e Komisionerit Publik, si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegji, dhe në bisedimet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, janë trajtuar dy procedime penale, procedimi penal për referimin penal me nr. {\*\*\*}, datë 26.3.2020, të dërguar nga Komisariati i Policisë Himarë, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë; dhe çështja penale nr. {\*\*\*} të vitit 2019, në ngarkim të shtetasve A. V. etj., të akuzuar për veprën penale “Kultivimi i narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 248/2 i Kodit Penal, të gjykuar në Gjykatën e Shkallës së Parë Vlorë.
70. Lidhur me dy procedimet penale, në ankim, Komisioneri Publik ka parashtruar se rrethanat e sipërcituara të lidhura me subjektin e rivlerësimit, në mënyrë konkrete, dy procedimet penale, që i përkasin prokurorisë ku ka ushtruar funksionin e prokurorit, janë një bazë e mjaftueshme për të hetuar në mënyrë të plotë në drejtim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, të ndërlidhura me nenet 73

---

<sup>8</sup> Neni 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016 përcakton: “[...] 10. Gjetja, e paraqitur në formën e një deklaratë, dokumenti ose raporti të dhënë nga vëzhguesi ndërkombëtar përbën provë që dëshmon një fakt, rrethanë ose standard ligjor, i cili ekziston ose ka ndodhur. Gjetja parashtron rrethanat për konstatimin e bërë. Komisioni ose Kolegji i Apelit e çmon gjetjen si të barasvlershme me mendimin e dhënë nga një ekspert. Refuzimi i gjetjes bëhet me vendim të arsytuar të Komisionit ose të Kolegjit të Apelit [...]”.

dhe 75 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

71. Në vijim, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, për procedimin penal nr. {\*\*\*}, datë 26.3.2020, ka parashtruar gjatë gjykimit në Kolegj, se nisur nga rrethanat e faktit dhe identiteti i personave dhe subjekteve të identifikuara në dosje, vëren rrethana që duket se referohen edhe në informacionin e institucioneve verifikuese mbi të cilat është hartuar edhe Raporti nr. {\*\*\*} prot., datë 11.11.2025, i AKSIK-së, i cili ka konkluduar me papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit.
72. Lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2019, në ngarkim të shtetasve A. V. etj., të akuzuar për veprën penale “Kultivimi i narkotikëve”, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme konstaton se, në përfundim të hetimit, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka kërkuar minimumin e dënimit për veprën penale të parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal, i cili, për këtë veprë, në rastin e kryerjes në bashkëpunim ose më shumë se një herë parashikon dënimin me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet. Gjithashtu, referuar konkluzioneve përfundimtare të prokurorit, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të dënimit për pjesën e pavuajtur të dënimit për të pandehurit A. V. dhe E.V., por nuk rezulton që të ketë identifikuar dhe analizuar rrethanat specifike të parashikuara nga neni 59 i Kodit Penal për aplikimin e tij.
73. Në vlerësim të shkaqeve të ankimit të ngritura për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale nga Komisioneri Publik dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, konstatohet dhe analizohet si në vijim.
74. ***Lidhur me mosfillimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, datë 26.3.2020***, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka referuar në të dhënat e Raportit të përditësuar të AKSIK-së, bazuar mbi të cilin ka konkluduar se rrethanat që identifikohen në aktet e procedimit penal duket se referohen edhe në informacionin e institucioneve verifikuese mbi të cilat është hartuar ky Raport. Nga përmbajtja e të dhënave të Raportit të AKSIK-së, duket se Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme i referohet informacionit *mbi të dhënat që disponohen për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e ushtrimit të ndikimit të paligjshëm, me qëllim lehtësimin e pozitës së të pandehurit.*
75. Nga aktet rezulton se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë është regjistruar referimi penal nr. {\*\*\*}, datë 26.03.2020, i kryer nga shërbimet e policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Himarë. Nga aktet e referimit penal ka rezultuar se në vendin e quajtur Livadh, Bashkia Himarë, në datën 07.03.2020, kanë filluar punimet për ndërtimin e një objekti të llojit hotel, ndërkohë që shtetasit V. Gj., A. K. dhe Dh. K. kanë pretenduar se punimet për ndërtimin e objektit kanë cenuar pjesë të sipërfaqes së tokës që është në pronësi të tyre. Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë për ndjekjen e këtij rasti është caktuar prokurori E. Sh.. Nga verifikimi i akteve të fashikullit të mosfillimit të procedimit penal rezulton se për referimin penal nr. {\*\*\*}, datë 26.03.2020, është vendosur mosfillimi i procedimit penal, me arsyetimin se fakti nuk përmban elementët e ndonjë vepre penale. Sipas akteve të përcjella me gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar, rezulton se nga komunikimet e kryera nëpërmjet aplikacionit SkyECC midis të pandehurit Aurel Zarka dhe të pandehurit në procedimin e lidhur R. Ç., se janë ofruar dhe janë kërkuar përfitime të parregullta, kundrejt

premtimit për të siguruar ushtrimin e ndikimit të paligjshëm të prokurori i çështjes, me qëllim favorizimin e palës për të cilën është bërë referimi penal. Lidhur me këtë çështje penale, Gjykata e Posaçme në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 20.05.2025, ka konkluduar se: *Gjatë gjykimit rezultoi e provuar se të dhënat që dalin nga komunikimet që realizojnë të pandehurit me njëri-tjetrin përputhen plotësisht me të gjitha provat e tjera shpresore pjesë e fashikullit të prokurorisë (aktet e dosjeve gjyqësore apo të fashikullit të prokurorisë etj.). Referuar këtyre provave rezulton e provuar qartësisht se i pandehuri Aurel Zarka ka kryer rolin e ndërmjetësit, duke premtuar ose siguruar aftësinë për të ushtruar ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës nga personat që ushtrojnë funksione publike (gjyqtarë apo prokurorë që kanë pasur për shqyrtim çështjet konkrete).*

76. Për sa rezulton më sipër, trupi gjykues vëren se fakti i ushtrimit të ndikimit të paligjshëm nga ana e subjektit të rivlerësimit për çështjen në fjalë konstatohet nga hetimet e kryera nga Prokuroria e Posaçme dhe mbetet për t'u provuar/konfirmuar gjatë gjykimit të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2024, për të cilin nuk ka ende një vendim përfundimtar nga gjykatat. Por lidhur me mosfillimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, datë 26.3.2020, trupi gjykues ndan të njëjtin qëndrim me Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme se rrethanat e faktit dhe identiteti i personave dhe subjekteve të identifikuar në aktet e këtij procedimi penal duket se referohen dhe në informacionin e institucioneve verifikuese mbi të cilat është hartuar Raporti nr. {\*\*\*} prot., datë 11.11.2025, i AKSIK-së, i cili ka konkluduar për papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit.

77. ***Për procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2019***, nga verifikimi i akteve të sjella për këtë procedim nga Gjykata e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, rezultojnë këto të dhëna:

77.1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë në datën 10.04.2020 ka paraqitur në Gjykatën e Shkallës së Parë Vlorë kërkesën për dërgimin në gjyq të procedimit penal në ngarkim të shtetasve A. V., A. V., E. V. dhe M. V., të akuzuar për veprën penale “Kultivimi i narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal. Kërkesa për dërgimin në gjyq është paraqitur nga prokurori i çështjes Aurel Zarka, i cili ka përfaqësuar akuzën edhe në fazën e gjykimit të çështjes penale.

77.2. Në seancën gjyqësore të datës 17.07.2020, prokurori i çështjes Aurel Zarka ka paraqitur konkluzionet përfundimtare me shkrim dhe ka kërkuar përfundimisht deklarinim fajtor të shtetasve A. V., A. V., E. V. dhe M. V., të akuzuar për veprën penale “Kultivimi i narkotikëve”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal dhe dënimin e secilit prej tyre me 5 (pesë) vjet burgim, duke zbritur më pas 1/3 e masës së dënimit. Për shtetasit A. V. dhe E. V. prokurori ka kërkuar që të aplikohet neni 59 i Kodit Penal, duke pezulluar ekzekutimin e vendimit me burgim dhe vendosjen e të dënuarve në provë për tre vjet.

77.3. Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 27.07.2020, ka vendosur deklarinim fajtor të shtetasve A. V., A. V., E. V. dhe M. V., për veprën penale që janë akuzuar, dënimin e secilit prej tyre me 5 vjet burgim dhe zbritjen e 1/3 të masës së dënimit. Gjithashtu, gjykata ka vendosur aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal për të katër të gjykuarit.

77.4. Nga akti “Konkluzione përfundimtare” të paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, gjatë gjykimit të procedimit penal, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, si prokuror i çështjes, ka kërkuar për të pandehurit dënimin me 5 vite burg, për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i narkotikëve”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal, duke zbritur më pas 1/3 e masës së dënimit. Për shtetasit A. V. dhe E. V., subjekti ka kërkuar që të aplikohet neni 59 i Kodit Penal, duke pezulluar ekzekutimin e vendimit me burgim dhe vendosjen e të dënuarve në provë për tre vjet.

78. Nga përmbajtja e aktit të mësipërm, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë asnjë argumentim lidhur me rrethanat specifike mbi bazën e të cilave ka paraqitur kërkesën për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, për pezullimin e ekzekutimit të dënimit për pjesën e pavuajtur të dënimit për dy prej të pandehurve. Neni 59 i Kodit Penal “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë” parashikon se: *“1. Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë, vjet, mund të urdhërojë që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale[...]”*. Neni 59 ka për qëllim riintegrimin social të autorit të veprës penale, kur ekzistojnë arsye të besueshme se ai nuk do të kryejë vepra të tjera penale dhe se qëllimi i dënimit mund të arrihet pa vuajtjen e menjëhershme të tij. Rrethanat që analizohen për të vendosur nëse do të zbatohet neni 59 janë personaliteti i autorit, mosha, edukimi, gjendja familjare e ekonomike, sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale nëse ka treguar pendesë, motivet që e shtynë autorin për kryerjen e kësaj vepre penale, e kaluar e tij penale, nëse është dënuar më parë dhe çfarë dënimesh ka pasur. Pra, zbatimi i nenit 59 kërkon një analizë të plotë individuale dhe morale të autorit dhe veprës, për të siguruar që pezullimi i dënimit nuk cenon interesat e drejtësisë dhe rendin shoqëror, por përkundrazi ndihmon në riintegrimin e të dënuarit.

79. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. 151, datë 18.06.2014, ndër të tjera, shprehet se: *“Nga interpretimi logjik e literal i kësaj dispozite, së pari evidentohet se zbatimi i nenit 59 të Kodit Penal është në diskrecion të gjykatës, e cila nëse çmon se plotësohet një ose disa nga kushtet e parashikuara nga kjo dispozitë vendos aplikimin e saj. Nga ana tjetër, në mënyrë që të aplikohet kjo dispozitë nga gjykata, duhet që të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet si më poshtë vijon: Së pari: Të ekzistojë një prej kushteve të renditur në pjesën e parë të paragrafit të parë të kësaj dispozite si rrezikshmëria e pakët e personit, autorit të veprës, mosha e të gjykuarit, kushtet shëndetësore apo mendore të tij, mënyra e jetesës dhe nevojat që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, të cilët janë kushte alternative jo kumulative. Pra, mjafton të evidentohet se ekziston njëri prej tyre së bashku me kushtin tjetër, të poshtërenditur; Së dyti: Gjykata të ketë dhënë ndaj të pandehurit, në përfundim të gjykimit, një dënim jo më të lartë se pesë vjet burgim. Pra, ligjvënësi e ka lidhur zbatimin e nenit 59 me masën e dënimit të dhënë nga gjykata (kur jep dënim me burg deri në pesë vjet) dhe jo me atë të parashikuar nga dispozita konkrete e pjesës së posaçme të Kodit Penal për të cilën është deklaruar fajtor i pandehuri. Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se, në mënyrë që të aplikohet në çdo rast konkret neni 59 i Kodit Penal, duhet të evidentohet ekzistenca e njërit prej kushteve alternative të renditur në pjesën e parë të fjalisë së parë të këtij neni dhe gjykata të ketë caktuar një dënim*

*deri në pesë vjet burgim.”. Më tej në këtë vendim thuhet se: “Arrihet në këtë konkluzion duke pasur parasysh vetë qëllimin e nenit 59 të Kodit Penal “ratio legis”, aplikimi i të cilit lidhet pikërisht me qëllimin riedukues të dënimit penal, i cili në disa raste çmohet se realizohet pa qenë e nevojshme që individi të izolohehet nga shoqëria. Prandaj kjo dispozitë, veç të tjerash vendos si kriter edhe dhënien e një dënimi deri në pesë vjet burgim duke pasur parasysh llojet e veprave për të cilat gjykata mund të caktojë një dënim të tillë, rrezikshmërinë relativisht të ulët të autorit dhe të veprës të cilat prezumohet të jenë çmuar një herë nga gjykata për caktimin e dënimit në bazë të fakteve dhe rrethanave të secilës çështje konkrete, të cilat, nga ana tjetër janë të njëjtat fakte dhe rrethana që mbahen parasysh prej saj edhe për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal”.*

80. Duke u kthyer në rastin konkret, në mungesë të një argumentimi dhe analize nga ana e subjektit të rivlerësimit, nuk është e qartë nëse dy të pandehurit kanë plotësuar kushtet për pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në shërbim prove, sipas parashikimeve të nenit 59 të Kodit Penal. Kjo pasi nga ana e subjektit të rivlerësimit në aktin “Konkluzione përfundimtare”, në mbështetje të kërkesës së tij për pezullimin e ekzekutimit të dënimit, nuk janë evidentuar dhe arsyetuar rrethana të tilla si rrezikshmëria e pakët shoqërore e të pandehurve, personaliteti i tyre, dhe nëse janë dënuar ndonjëherë për ndonjë vepër penale. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë mbi sjelljen e të pandehurve pas kryerjes së veprës penale, gjendjen familjare apo arsimin e tyre, dhe nga subjekti i rivlerësimit nuk është arsyetuar se përse vendosja në kushte burgimi nuk do të ishte në përputhje me gjendjen e të pandehurve dhe nuk do të shërbente për riedukimin e tyre.
81. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka parashtruar se subjekti i rivlerësimit ka kërkuar minimumin e dënimit për veprën penale të parashikuar nga neni 284, paragrafi i dytë i Kodit Penal, “Kultivimi i bimëve narkotike”. Ky nen parashikon se *Kultivimi i bimëve, që shërbejnë ose dihet se shërbejnë për prodhimin dhe nxjerrjen e lëndëve narkotike dhe psikotrope, pa leje dhe autorizim sipas ligjit, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.* Lidhur me këtë konstatim të ankuesit, vihet se ai nuk jep asnjë argument në drejtim të mangësisë profesionale së subjektit të rivlerësimit në caktimin e masës së dënimit, por e konsideron këtë rrethanë me peshë në konsideratë të informacioneve të organeve ligjzbatuese. Në kushtet kur nuk rezulton asnjë e dhënë mbi argumentimin e subjektit të rivlerësimit mbi masën e dënimit të kërkuar, në vlerësimin e trupit gjykues, rrethanat lidhur me masën e dënimit si dhe aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal vlerësohen, ashtu si dhe pretendon Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në kuadër të informacioneve që rezultojnë nga organet ligjzbatuese.
82. Sa më sipër, në lidhje me shkaqet e ankimit të ngritura nga Komisioneri Publik për procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2019, e të mbështetura nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, trupi gjykues, nga analizimi i akteve të këtij procedimi penal, vlerëson se qëndron konstatimi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme për mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit në trajtimin e kësaj çështjeje penale, për sa i përket argumentimit të aplikimit të nenit 59 të Kodit Penal, të cilat vlerësohen dhe në konsideratë të informacioneve që rezultojnë nga agjencitë ligjzbatuese. Bazuar në indikatorët vlerësues të parashikuar nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, trupi gjykues vëren mangësi në veprimtarinë e subjektit të rivlerësimit si prokuror, në aspektin

e njohurive ligjore dhe të arsytimit ligjor, të cilat, në tërësinë e tyre, nuk konsiderohen si të mjaftueshme për t'u kualifikuar sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, por u mbajtën në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

83. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi gjetjen e sjellë në Kolegj nga vëzhguesi ndërkombëtar, me shkresën nr. {\*\*\*} ex. 2024, datë 12.01.2026, si dhe qëndrimet e palëve lidhur me provueshmërinë e komunikimeve të koduara të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet aplikacionit SkyECC, konstaton se të dhënat që rezultojnë nga aktet e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2024, i Prokurorisë së Posaçme, në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Aurel Zarka, konkretisht nga procesverbalet në lidhje me identifikimin e përdoruesit të kodeve të ndryshme PIN, të kryqëzuara njëkohësisht edhe me prova e akte shkresore dhe nga burime të hapura, provojnë përfshirjen e tij, në mënyrë sistematike, në komunikime të koduara. Këto komunikime rezultojnë të provuara dhe sipas vendimit nr. {\*\*\*}/2025 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila ka çmuar se provat e paraqitura nga organi i akuzës nuk janë të dyshimta, të pakonfirmuara dhe kontradiktore, por ato janë të lidhura dhe në sinkron me njëra-tjetrën [...] dhe mbrojtësi i të pandehurit nuk ngriti pretendime mbi vlefshmërinë e akteve apo papërdorshmërinë e provave. Në dritën e këtyre rrethanave, trupi gjykues çmon të theksojë se faktet objektive të evidentuara në dosje, si ekzistenca e komunikimeve të koduara, të papërshtatshme, të subjektit të rivlerësimit, që lidhen me akte konkrete hetimore dhe gjyqësore, në kuptim të procesit të rivlerësimit kalimtar, merren në analizë në drejtim të vlerësimit të integritetit të figurës së subjektit të rivlerësimit në raport me standardet e integritetit dhe besimit publik që kërkohen nga funksioni i magjistratit, pavarësisht nëse këto komunikime apo sjelljet dhe veprimet e tij në ndërveprim me persona të tjerë përbëjnë apo jo vepër penale.
84. Në çështjen *Oleksandr Volkov kundër Ukrainës*, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, (në vijim “GjEDNj”) ka pranuar se procedurat disiplinore ose të vlerësimit profesional kanë natyrë autonome nga procedimi penal, për sa kohë ato analizojnë përputhshmërinë e sjelljes me standardet e funksionit dhe jo ekzistencën e një vepre penale. Po ashtu, në çështjen *Baka kundër Hungarisë*, Gjykata ka theksuar rëndësinë e mbrojtjes së pavarësisë së gjyqësorit, por ka njohur edhe kompetencën e shtetit për të vendosur standarde të larta etike për funksionarët e drejtësisë. Nga kjo jurisprudencë rezulton se organet disiplinore ose të rivlerësimit mund të mbështeten në fakte që janë objekt hetimi penal, për sa kohë ato nuk shpallin faj penal dhe nuk e zëvendësojnë gjykimin penal. Në jurisprudencën e saj, GjEDNj-ja ka theksuar se klasifikimi i një mase si “administrative” apo “disiplinore” nuk varet vetëm nga terminologjia formale, por nga natyra dhe qëllimi i saj (*kriteret Engel*). Megjithatë, edhe kur një masë ka pasoja të rënda për karrierën, ajo nuk shndërrohet automatikisht në “akuzë penale”, në kuptim të nenit 6, nëse qëllimi i saj është rregullator dhe jo ndëshkues.
85. Për pasojë, në çështjen objekt gjykimi, trupi gjykues arrin në përfundimin se faktet e konstatuara lidhur me komunikimet e papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet aplikacionit SkyECC janë të mjaftueshme për të vlerësuar në kuadër të këtij procesi me natyrë administrative, integritetin e figurës së magjistratit, në kuptim të parashikimeve të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe Kreut V “Kontrolli i figurës” të ligjit nr. 84/2016, si dhe përshtatshmërinë e sjelljes së tij në raport me vlerat themelore, standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së magjistratit, kombëtare dhe ndërkombëtare, nga të cilat kërkohet një standard i

lartë sjelljeje, gjatë ushtrimit të detyrës dhe jashtë saj, në kuadër të moscenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, si pasojë e dyshimeve të arsyeshme që mund të lindin në perceptimin e një vëzhguesi të jashtëm mbi integritetin e figurës së një magjistrati, kur ai përfshihet në komunikime të koduara si ato të evidentuara në procedimin penal nr. {\*\*\*}/2024, pavarësisht nëse provohet apo jo konsumimi i ndonjë vepre penale.

86. Trupi gjykues i gjeti të pabazuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit se shqyrtimi dhe vendimmarrja e Kolegjit, bazuar mbi fakte dhe rrethana të evidentuara në një procedim penal, për të cilin nuk është dhënë një vendim gjyqësor i formës së prerë, cenon parimin e prezumimit të pafajësisë, për sa kohë fryma që Kushtetuta dhe Aneksi i saj përçojnë dhe shprehin në mënyrë të qartë dallimin mes procesit të rivlerësimit kalimtar dhe procesit penal, ku standardet e provueshmërisë së akuzës penale u nënshtrohen rregullave dhe parimeve të legjislacionit penal dhe, në këtë kuptim, standardi i provës është ai i “bindjes së arsyeshme” mbi cenimin e besimit publik dhe jo standardi penal “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”. Trupi gjykues mban në konsideratë nenin 6 §2<sup>9</sup> të Konventës dhe jurisprudencën e GjEDNj-së në çështjen *Oleksandr Volkov kundër Ukrainës* dhe *Kamenos kundër Qipros*<sup>10</sup>, sipas së cilës një procedim disiplinor ndaj aplikantit nuk përfshinte dhe përcaktimin e një akuze penale ndaj tij. Për rrjedhojë, procesi i zhvilluar dhe konkluzionet e arritura në mënyrë autonome në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, kurrsesi nuk mund të diktojnë apo të ndikojnë në ecurinë e procedimit penal në ngarkim të subjektit të rivlerësimit.
87. Trupi gjykues çmon se sjelljet e konstatuara lidhur me kriterin e kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, së bashku me gjetjet lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, janë të papajtueshme me etikën dhe rolin e magjistratit, dëmtojnë rëndë besimin e publikut në sistemin e drejtësisë dhe çojnë në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk përmbush standardet kushtetuese dhe ligjore të integritetit të nevojshëm për vazhdimin e ushtrimit të detyrës, duke sjellë si pasojë zbatimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
88. Në konkluzion, pas problematikave të konstatuara si më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, mbështetur në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Aurel Zarka gjendet i papërshtatshëm për të vijuar detyrën. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit çmon se vendimi nr. 779, datë 28.06.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i pabazuar në fakte e në ligj dhe, si i tillë, duhet të ndryshohet.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

---

<sup>9</sup> “Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht”.  
<sup>10</sup> Paragrafët 93-95 në Vendimin e GjEDNj-së, për çështjen *Oleksandr Volkov v. Ukraine*; Paragrafët 51-53 në Vendimin e GjEDNj-së, për çështjen *Kamenos v. Cyprus*.

## VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 779, datë 28.06.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Aurel Zarka.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 05.03.2026, në Tiranë.

### **ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

### **ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

### **ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

### **RELATORE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

### **KRYESUESE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*